FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 143

Tiranë – E martë, 4 gusht 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 101/2020 datë 23.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.....	9109
Dekret i Presidentit nr. 11573, datë 31.7.2020	Për shpallje ligji.....	9134

LIGJ
Nr. 101/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008, "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 shtohen pikat me këtë përmbajtje:

"26. "Gjini e nënpërfaqësuar" është gjinia me tradicionalisht numrin më të vogël të anëtarëve në Kuvend ose, sipas rastit, në këshillat vendorë në rang vendi.

27. "Identifikimi elektronik" është identifikimi i zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përqasja e tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike.

28. "Shpenzime të fushatës zgjedhore" janë shpenzimet e bëra nga ose në emër të një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët dhe/ose degët e tij, ose të një kandidati të pavarur, të cilat kryhen për të promovuar fushatën e vet ose për të dëmtuar fushatën e një subjekti tjetër, përfshirë kandidatët e tij, pavarësisht datës se kur janë kryer.

29. "Votim për të tretët" është votimi kur zgjedhësi voton në emër dhe për llogari të personave të tjerë, të pranishëm ose jo në qendrën e votimit. Përveçse kur bëhet votimi i asistuar sipas këtij ligji, votimi për të tretët është i kundërligjshëm dhe dënohet sipas Kodit Penal.

30. "Votim familjar" është formë e votimit për të tretët dhe ndodh kur një pjesëtar i familjes, si rregull kryefamiljari, voton në emër dhe për llogari të pjesëtarëve të tjerë.

31. "Materiale propaganduese statike" janë materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse etj.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1 Subjektet zgjedhore përfitojnë financime publike dhe jopublike në mbështetje të fushatës së tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse. Subjektet zgjedhore bartin detyrimin për transparencë dhe publikim të të ardhurave dhe shpenzimeve në zgjedhje kundrejt KQZ-së, personave të ngarkuar me auditimin apo monitorimin dhe publikut.".

2. Në fund të pikës 8 shtohen fjalitë si vijon:

"Policia e Shtetit i ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore. Veprimtaria e saj zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.".

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4
Ligji zgjedhor dhe barazia gjinore

1. Ky ligj garanton respektimin e parimit të barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që i jep këtij parimi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë së nënpërfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim ose në shkelje të këtij parimi.

2. Detyrimi për respektimin e parimit të barazisë gjinore u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë mbi tagrat që subjektet zgjedhore kanë sipas këtij ligji, të kërkojë nga subjektet zgjedhore

pushimin e cenimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij.

3. Ligji zgjedhor nxit barazinë gjinore për organet e zgjedhura dhe administratën zgjedhore përmes:

a) vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njësive bazë të qeverisjes vendore;

b) vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së të gjitha niveleve të administratës zgjedhore;

c) marrjes së masave në reduktimin dhe eliminimin e votimit për të tretët, votimit familjar, ruajtjen dhe garantimin e fshehtësisë së votimit.

ç) hartimit dhe publikimit të statistikave operative për pjesëmarrjen e gjinisë së nënpërfaqësuar në ditën e zgjedhjeve, me qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të duhura për të nxitur më tej këtë pjesëmarrje.".

Neni 4

Përmbajtja e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

"Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 prilli deri në 15 maj ose nga 15 tetori deri në 15 nëntor. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8 të nenit 9 të këtij ligji.".

Neni 5

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

Caktimi i datës së zgjedhjeve për Kuvendin

1. Data e zgjedhjeve për Kuvendin caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, sipas rregullave të parashikuara në nenin 65 të Kushtetutës. Zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen në një ditë të diel brenda periudhës zgjedhore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Për efekt të caktimit të datës së zgjedhjeve, kohëzgjatja e mandatit të Kuvendit përllogaritet deri në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt pas datës së mbledhjes së parë të tij.

3. Midis datës së zgjedhjeve dhe datës së mbarimit të mandatit të Kuvendit duhet të ketë një diferencë prej së paku 30 ditësh. Në rast se diferenca është më e vogël se 30 ditë, atëherë data e zgjedhjeve afrohet me aq javë sa duhen për të plotësuar kushtin sipas kësaj pike, pavarësisht nëse data e zgjedhjeve bie përpara fillimit të periudhës zgjedhore.

4. Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit.

5. Në zbatim të pikës 5 të nenit 87 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes së Kuvendit. Zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit. Datë e shpërndarjes së Kuvendit është data e votimit të pestë, sipas pikës 5 të nenit 87 të Kushtetutës, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Presidentin e ri.

6. Në zbatim të pikës 4 të nenit 96 të Kushtetutës, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, jo më vonë se 24 orë pas votimit të parashikuar në pikën 3 të po atij neni, Presidenti i Republikës dekreton shpërndarjen e Kuvendit dhe cakton datën e zgjedhjeve. Zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

7. Në zbatim të pikës 2 të nenit 104 të Kushtetutës zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

8. Kur për shkaqe të tjera nga ato të përmendura në këtë nen Kuvendi vetëshpërndahet, atëherë Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes së tij. Kuvendi shpërndahet në ditën e votimit të tij për vetëshpërndarje. Zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.".

Neni 6

Pikat 1 dhe 2 të nenit 11 ndryshohen si më poshtë:

"1. Kur data e zgjedhjeve caktohet në periudhën zgjedhore nga 15 prilli deri më 15 maj, qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00.

2. Kur data e zgjedhjeve caktohet në periudhën zgjedhore nga 15 tetori deri më 15 nëntor, qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 18:00.".

Neni 7

Kreu I i pjesës II, me nenet 12 deri 26, ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12
Përbërja dhe funksionimi i KQZ-së

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

2. Organet drejtuese të KQZ-së janë:

a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

b) Komisioni Rregullator; dhe

c) Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.

4. Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Rregullatori funksionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në mbledhje publike, të cilat thirren nga Komisioneri. Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin ose KAS-in kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmblidhen me kërkesë të çdo anëtari. Për pjesëmarrjen në mbledhje anëtarët e Rregullatorit përfitojnë shpërblim në masën 50 për qind të pagës mujore të Komisionerit, por jo më shumë se 80 për qind të pagës vjetore të këtij të fundit.

5. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor. KAS-i funksionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në seanca publike të shqyrtimit administrativ, të cilat thirren nga Komisioneri, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin ose KAS-in kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmblidhen me kërkesë të çdo anëtari. Për veprimtarinë e tyre gjatë periudhës, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin, zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ose zgjedhjeve të pjesshme, deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, anëtarët e KAS-it përfitojnë shpërblim të barabartë me shumën e pesë pagave mujore të Komisionerit. Për veprimtarinë që zhvillojnë jashtë kësaj periudhe, anëtarët e KAS-it përfitojnë shpërblim në masën 50 për qind të pagës mujore të Komisionerit.

6. Anëtarët e Rregullatorit dhe të KAS-it nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyra të tjera brenda organeve, institucioneve apo enteve, pjesë e pushtetit ekzekutiv.

7. Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe e administratës udhëhiqet, sipas rastit, nga ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.".

Neni 13
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

1. Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 7-vjeçar, të përtëritshëm, sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj.

2. Kanë të drejtën të kandidojnë ose të propozohen për komisioner, shtetasit shqiptarë që vijnë nga radhët e ish-funksionarëve politikë apo të kabineteve, ish-nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, ose të-ish drejtuesve të organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të të drejtave të njeriut.

3. Përzgjedhja e Komisionerit bëhet në bazë të eksperiencës së mëparshme të suksesshme në drejtim të ligjshmërisë së demonstruar ose të provuar në ushtrimin e detyrave apo funksioneve dhe të reputacionit publik të kandidatit. Dokumentet apo referencat provuese të kandidatit për suksesin dhe ligjshmërinë në ushtrimin e detyrave duhet të shtrihen së paku për një periudhë vazhduese 3-vjeçare veprimtarie.

4. Personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nëse në momentin e kandidimit ka qenë në ushtrim të detyrës si funksionar, anëtar i kabinetit, nëpunës i nivelit të lartë drejtues, apo drejtues i organizatës jofitimprurëse, ose kur komisioni kompetent i Kuvendit krijon bindjen se marrëdhënien e tij të punës e ka ndërprerë për shkak të kandidimit ose propozimit për komisioner.

5. Personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nga Kuvendi nëse është anëtar aktiv i ndonjë partie politike, ose nëse ka interesa private, të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror ose vendor.

6. Paga dhe privilegjet e Komisionerit janë të njëjta me pagën dhe privilegjet e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

7. Komisioneri u nënshtrohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave.

Neni 14
Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

1. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (nënkomisioneri) zgjidhet nga Kuvendi për një periudhë 4-vjeçare me detyrën për të monitoruar dhe mbikëqyrur implementimin e teknologjisë për identifikimin elektronik, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë.

2. Nënkomisioneri është përgjegjës për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Ai bashkushtron me të drejta të barabarta me komisionerin kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Neni 15
Komisioni Rregullator

1. Komisioni Rregullator (Rregullatori) përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët njeri ushtron detyrën e kryetarit. Kryetari dhe anëtarët e rregullatorit zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 5-vjeçar, sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj për Komisionerin.

2. Kandidati për kryetar ose anëtar i Rregullatorit duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret për të qenë Komisioner. Kriteri i eksperiencës së mëparshme të suksesshme në drejtim zëvendësohet për kandidatin për anëtar të Rregullatorit me kriterin e eksperiencës së mëparshme të suksesshme në hartimin, shqyrtimin ose oponencën e legjislacionit. Dokumentet apo referencat provuese të kandidatit për suksesin dhe ligjshmërinë në ushtrimin e detyrave duhet të shtrihen së paku për një periudhë vazhduese 3-vjeçare veprimtarie.

3. Mënyra e funksionimit të Rregullatorit dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të akteve përcaktohen në rregulloren e mbledhjeve të Rregullatorit.

4. Anëtarët e Rregullatorit u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave.

Neni 16
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

1. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 9-vjeçar, sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj.

2. Kanë të drejtë të kandidojnë ose të propozohen për anëtar të KAS-it shtetasit shqiptarë që vijnë nga radhët e ish-gjyqtarëve, ish-këshilltarëve në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë, ish-anëtarëve të KQZ-së, ish-nëpunësve të nivelit të lartë drejtues ose të juristëve në profesion të lirë, me përvojë në gjykime administrative.

3. Përzgjedhja e anëtarit të KAS-it bëhet në bazë të eksperiencës së mëparshme të suksesshme në shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ligjshmërisë së demonstruar ose të provuar në ushtrimin e detyrave apo funksioneve dhe të reputacionit publik të kandidatit. Dokumentet apo referencat provuese të kandidatit për suksesin dhe ligjshmërinë në ushtrimin e detyrave duhet të shtrihen së paku për një periudhë vazhduese 3-vjeçare veprimtarie.

4. Personi që kandidon ose që propozohet për anëtar të KAS-it nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nëse në momentin e kandidimit ka qenë në ushtrim të funksioneve si gjyqtar, këshilltar në Gjykatën Kushtetuese ose në

Gjykatën e Lartë, anëtar i KQZ-së ose nëpunës i nivelit të lartë drejtues, ose kur komisioni përgjegjës i Kuvendit krijon bindjen se marrëdhënien e tij të punës e ka ndërprerë për shkak të kandidimit ose propozimit për anëtar të KAS-it.

5. Personi që kandidon ose që propozohet për anëtar të KAS-it nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nga Kuvendi nëse është anëtar aktiv i ndonjë partie politike, ose nëse ka interesa të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror ose vendor.

6. Mënyra e funksionimit të KAS-it dhe procedurat e shqyrtimit të çështjeve përcaktohen në rregulloren e seancave të KAS-it.

7. Anëtarët e KAS-it u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave.

Neni 17
Zgjedhja e Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it

1. Komisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e KAS-it zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me jo më pak se tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

2. Paraqitja e kandidaturave bëhet nëpërmjet vetofrimit ose propozimit nga grupet parlamentare ose deputetët e veçantë.

3. Për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave, Kuvendi ngre komision të posaçëm parlamentar, me përfaqësim proporcional nga çdo grup parlamentar. Procedura e kandidimit dhe e përzgjedhjes së kandidaturave kryhet sipas dispozitave të rregullores së Kuvendit për zgjedhjen në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë nen.

4. Komisioni i posaçëm parlamentar vlerëson me pikë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara, sipas rastit, në nenet 13, 15 ose 16 të këtij ligji. Komisioni i paraqet Kuvendit për votim listën e kandidatëve, e cila përmban deri në 20 emra të kandidatëve kalues, me vlerësimin më të lartë. Për secilën kandidaturë të listës shënohet propozuesi dhe organizatat apo partitë politike mbështetëse, nëse ka.

5. Në rast se Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Komisionerin, apo anëtarë të caktuar të Rregullatorit ose të KAS-it, me shumicën e kërkuar të votave sipas pikës të parë të këtij neni, atëherë administrata e Kuvendit hedh short midis të gjitha kandidaturave të paraqitura për votim Kuvendit për vendin përkatës. Fituesi i njoftohet Kuvendit dhe shpallet i zgjedhur në seancë plenare nga Kryetari i Kuvendit.

Neni 18
Shkarkimi i Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it

1. Shkarkimi i Komisionerit bëhet vetëm për të njëjtat shkaqe (kushte dhe kritere), për të cilat nuk do të lejohej zgjedhja në detyrë e tij. Shkaqet për shkarkim duhet të kenë ndodhur pas fillimit të detyrës dhe duhet të jenë vërtetuar nga organet shtetërore që kanë kompetencë vërtetimin e tyre.

2. Shkarkimi i anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it bëhet për të njëjtat shkaqe (kushte dhe kritere), për të cilat nuk do të lejohej zgjedhja e tyre në detyrën përkatëse, si dhe për mosushtrim të detyrës, pa shkak të ligjshëm, për së paku tri mbledhje ose seanca të njëpasnjëshme. Konflikti i anëtarit me kushtet dhe kriteret, që përbëjnë shkak për shkarkim, duhet të ketë ndodhur pas fillimit të detyrës dhe duhet të jetë vërtetuar nga organet shtetërore që kanë kompetencë vërtetimin e tij.

3. Në procedurën e shkarkimit, komisioni përgjegjës i Kuvendit nuk mund të bëjë vërtetimin e shkaqeve, por vetëm administrimin e dokumenteve zyrtare të formës së prerë, që vërtetojnë ekzistencën e shkaqeve për shkarkim.

4. Procedura e shkarkimit kryhet sipas dispozitave të Rregullores së Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë nen.

5. Komisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e KAS-it shkarkohen kur "pro" shkarkimit votojnë jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

6. Kur Komisioneri, apo anëtarët e Rregullatorit dhe të KAS-it shkarkohen ose kur vendi i tyre ngelet vakant për çfarëdo lloj motivi tjetër, anëtarët e rinj zgjidhen në detyrë me mandat të plotë.

Neni 19
Kompetencat e Komisionerit

1. Komisioneri ka këto kompetenca:

a) drejton institucionin dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët;

b) drejton dhe mbikëqyr, drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së, veprimtarinë e administratës zgjedhore përgjatë zgjedhjeve dhe referendumeve;

c) vë në lëvizje Rregullatorin dhe KAS-in sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tyre, u përgatit mbledhjet dhe seancat, si dhe kujdeset për zbardhjen dhe publikimin e akteve. Komisioneri nuk mund të vendosë për çështje që janë kompetencë e Rregullatorit apo KAS-it;

ç) emëron dhe shkarkon anëtarët e KZAZ-ve;

d) lidh, në emër të KQZ-së, marrëveshje dhe kontrata me të tretët dhe monitoron ose kontrollon zbatimin e tyre;

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

e) organizon dhe administron proceset zgjedhore të institucioneve dhe organizmave publike, kur ligji e ngarkon me këtë detyrë;

ë) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara fushatën zgjedhore, të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, si dhe pasqyrimin e fushatës në media;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

g) kujdeset për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve;

gj) drejton procesin e trajnimit dhe kualifikimit të administratës zgjedhore, trajnimin e financierëve të subjekteve zgjedhore, trajnimin e monitoruesve dhe auditëve financiarë, si dhe trajnimin e përfaqësuesve të OJF-ve që vëzhgojnë dhe monitorojnë aspektet e financimit të fushatës;

h) informon publikun për veprimtarinë e KQZ-së, për vendimmarrjen, për fushatën, procesin e votimit dhe rezultatin e zgjedhjeve;

i) miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për Kuvendin dhe për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo deputet dhe për kryetarët e bashkive, territori i të cilave është i ndarë në më shumë se një ZAZ;

j) prodhon dhe publikon të dhëna statistikore për zgjedhjet në vite, të dhëna statistikore për raportet gjinore në zgjedhje, administrimin e tyre, në kandidim dhe në organet e zgjedhura, si dhe të dhënat për listat e kandidatëve të Kuvendit dhe të organeve të qeverisjes vendore;

k) administron buxhetin e KQZ-së, sipas rregullave të fushës;

l) përgatit projektbuxhetin vjetor dhe atë për zgjedhjet, sipas ligjit përkatës, si dhe pas miratimit me ligj të buxhetit përcakton strukturën e shpenzimeve buxhetore.

ll) raporton përpara Kuvendit për veprimtarinë e institucionit, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit që lidhet me zgjedhjet;

m) përgatit dhe i përcjell për miratim Kuvendit strukturën dhe organikën e administratës së KQZ-së, me kohë të plotë pune dhe asaj me kohë jo të plotë;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

2. Aktet administrative bazë të Komisionerit në ushtrimin e detyrës janë vendimet, urdhrat dhe udhëzimet.

Neni 20

Kompetencat e Rregullatorit

1. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për:

a) rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje;

b) rregullat dhe udhëzimet për njehsimin dhe përmirësimin e praktikave zgjedhore, si dhe për veprimtarinë e institucioneve publike në shërbim të zgjedhjeve;

c) rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit;

ç) rregullat për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore;

d) rregulloren e mbledhjeve të Rregullatorit dhe rregulloren e seancave të KAS-it;

dh) rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin;

e) llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë;

ë) rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre;

f) rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, rolin dhe përgjegjësitë e financierëve të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre, si dhe për hetimin administrativ të informacioneve, kërkesave, propozimeve, ankesave apo denoncimeve për shkelje lidhur me financimin apo shpenzimet e fushatës;

g) rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor;

gj) udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve;

h) tarifat e shërbimit për organizimin dhe administrimin e proceseve zgjedhore të institucioneve dhe organizmave publike, kur ligji e ngarkon me këtë detyrë;

2. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së,

për:

a) kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor në përputhje me këtë ligj;

b) numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend;

c) përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi;

ç) zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin;

d) rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi në përputhje me këtë ligj.

3. Aktet administrative bazë të Rregullatorit në ushtrimin e detyrës janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë, përveç vendimeve sipas shkronjave "b" dhe "d" të pikës 2 të këtij neni, të cilat miratohen me shumicë të thjeshtë.

Neni 21
Kompetencat e KAS-it

1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca:

a) vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve;

b) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit;

c) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ëve;

ç) vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve për çështjet që shqyrton.

d) me kërkesë të Komisionerit vendos masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim;

dh) me kërkesë të Komisionerit vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

2. Secili anëtar i KAS-it ka të drejtë që gjatë hetimit administrativ të marrë kryesisht, pa debat dhe as votim, prova që janë në administrim të KQZ-së.

3. Aktet administrative bazë të KAS-it janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë, përveç vendimit sipas shkronjave "a", "b" ose "c" të pikës 1, kur objekt i ankimit është kundërshtimi i tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Në këtë rast vendimi merret kur pro tij votojnë së paku katër anëtarë.

Neni 22
Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje

1. KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor, të angazhojë konsulencë të huaj për këtë qëllim, si dhe të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre. KQZ-ja është e detyruar që përdorimin e sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit ta zbatojë në zgjedhje nëpërmjet projekteve pilot, në jo më pak se 10 për qind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit.

2. KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme videomonitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave, në VNV-të, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Sistemi i videomonitorimit nuk mund të instalohet në qendrat e votimit në mënyrë të tillë që të cenojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit. Nëse nuk e kryen vetë, KQZ-ja ka të drejtë të prokurojë instalimin ose edhe operimin e sistemit të videomonitorimit.

3. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit, që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat procedurale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të KQZ-së.

4. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin paszgjedhor të tyre, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura, si dhe të jenë të aplikueshme së paku për pesë procese zgjedhore të njëpasnjëshme.

5. Identifikimi, përzgjedhja dhe përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit u nënshtrohen parimeve të ligjshmërisë, transparencës, gjithëpërfshirjes, sigurisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.

6. Përpara çdo procesi zgjedhor, sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit duhet t'i nënshtrohen testimit operacional nga KQZ-ja në seanca publike dhe me procedurë të saktë dhe të detajuar, duke përzgjedhur me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore jo më pak se tre për qind të pajisjeve që do të përdoren dhe duke simuluar me to veprimet operacionale zgjedhore për një numër jo më të vogël se 50 votues.

7. Pas çdo procesi zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe konstituimit të organeve të zgjedhura, KQZ-ja kryen në seanca publike dhe me procedurë të detajuar verifikimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike, që janë përdorur për votimin dhe numërimin e votave në zgjedhje, nëpërmjet numërimit manual të jo më pak se 10 për qind të qendrave të votimit dhe krahasimit të rezultatit me rezultatin e nxjerrë nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Qendrat e votimit përzgjidhen nga KQZ-ja me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore.

8. Rezultatet e testimit parazgjedhor dhe të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit kushtëzojnë vendimmarrjen e KQZ-së për përdorimin në vijim të teknologjisë. Rezultatet e testimit parazgjedhor dhe të verifikimit paszgjedhor mund të bëhen objekt i hetimit për kryerje të veprës penale nëse nxjerrin të dhëna dhe krijojnë dyshime për kryerjen e veprave penale nëpërmjet keqpërdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit në zgjedhje.

Neni 23
Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja

1. Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit në zgjedhje vihen në përdorim nga personeli i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, përveçse kur Rregullatori vendos që përdorimi i tyre të bëhet nga operatorë privatë të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin e shërbimeve. Prokurimi i shërbimit mund të jetë pjesë e kontratës për prokurimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mund të kryhet edhe nga furnizuesi i këtyre të fundit.

2. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit kryhet në përputhje

me rregulloren teknike të përdorimit, e cila, përveç rregullave që burojnë nga manuali i përdorimit, duhet të përfshijë rregullat për testimin parazgjedhor, për dokumentimin e procedurave operacionale, për konstatimin dhe raportimin e defekteve, shkeljeve apo dhunimeve gjatë operimit, për pezullimin e operacioneve me dhe nëpërmjet sistemeve apo pajisjeve dhe kryerjen e procedurave manualisht, si dhe për përmbylljen e veprimeve operacionale me dhe nëpërmjet sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe raportimin e rezultateve. Rregullorja teknike e përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike miratohet me akt normativ të KQZ-së.

3. Në rastet kur nga testimi parazgjedhor rezulton se sistemet apo pajisjet shfaqin defekte apo pasaktësi operacionale, të cilat mund të cenojnë integritetin e tyre apo të procedurave, atëherë KQZ-ja mund të vendosë zbatimin e procedurave manualisht dhe të heqë sistemet apo pajisjet nga përdorimi në zgjedhjet e radhës.

Neni 24
Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë vendit

1. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.

2. Votimi nga jashtë vendit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij ligji.

3. KQZ-ja duhet të marrë vendim për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit.

4. Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të KQZ-së.

Neni 25
Procedura e votimit nga jashtë vendit

1. Pavarësisht nga procedura e votimit, manuale ose elektronike, votat e votuesve nga jashtë vendit administrohen nga KQZ-ja, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshehtësinë e votës nga çdo ndërhyrje mbi fletët e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj.

2. Votimi nga jashtë vendit quhet i çelur nga dita që KQZ-ja nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit ose, sipas rastit, dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit. Votimi nga jashtë vendit mbyllet në ditën e votimit, në orën e caktuar nga ky ligj për mbylljen e votimit në qendrat e votimit. Me mbylljen e votimit nga jashtë vendit, KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë më në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur më pas. Nëse votimi nga jashtë vendit bëhet elektronik, sistemi elektronik i votimit mbyllet në orën e caktuar nga ky ligj për mbylljen e votimit në qendrat e votimit.

3. Rregullat për administrimin e materialit zgjedhor ose të informacionit të votimit, të regjistruar dhe ruajtur nga sistemet e teknologjisë informatike, për votimin nga jashtë vendit, si dhe për testimin parazgjedhor dhe verifikimin paszgjedhor të sistemeve janë pjesë e rregullave të përgjithshme që KQZ-ja miraton për administrimin e materialit zgjedhor apo për përdorimin e sistemeve të teknologjisë informatike në zgjedhje. Garancitë ligjore për vëzhgimin, monitorimin dhe aksesin në KQZ gjatë administrimit të votave nga jashtë vendit, si dhe për testimin, verifikimin dhe sigurinë e materialit zgjedhor apo të sistemeve të teknologjisë informatike që përdoren për këtë votim nuk mund të jenë më të ulëta sesa ato për votimin brenda vendit.

Neni 26
Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ

1. Partitë politike ose koalicionet e partive politike, që regjistrohen për të marrë pjesë në zgjedhje, nëpërmjet personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në, mund të caktojnë me autorizim një përfaqësues dhe një zëvendës të tij

pranë KQZ-së, me tagra përfaqësimi për gjithë periudhën deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar. Përfaqësuesit e partive parlamentare i ushtrojnë tagrat e përfaqësimit edhe jashtë periudhës së përcaktuar në fjalinë e parë të kësaj pike.

2. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ kanë të drejtë:

a) të paraqesin kërkesa dhe propozime pranë KQZ-së;

b) të marrin kopje të akteve të KQZ-së;

c) të njihen dhe të marrin informacion për të gjitha aspektet e procesit zgjedhor, pa cenuar veprimtarinë e KQZ-së, pa cenuar fshehtësinë e hetimeve administrative vijuese apo veprimtarinë e strukturave të tjera zgjedhore;

ç) të njihen dhe të marrin kopje të dokumentacionit zgjedhor, të miratuar nga KQZ-ja;

d) të marrin pjesë në mbledhjet e Rregullatorit, të diskutojnë në mbrojtje të interesave të ligjshme të subjektit, të paraqesin amendamente për projektaktet që shqyrtohen dhe të marrin fjalën për shtjellimin e amendamenteve të propozuara prej tyre;

dh) të paraqiten, kur legjitimohet subjekti, si palë në seancat e KAS-it dhe të mbrojnë interesat e subjektit.

Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ konsiderohen sikur të jenë kryer nga vetë subjektet zgjedhore.

3. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore janë të detyruar të respektojnë rregulloret e KQZ-së, si dhe etikën e mbledhjeve dhe të komunikimit. Në rast të thyerjes së tyre merren masat e parashikuara në rregullore.".

Neni 8

Në nenin 27, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Për Bashkinë e Tiranës secila nga njësitë administrative ish-njësi bashkiake përbëjnë zonë administrimi zgjedhor më vete.".

Neni 9

Në nenin 28, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Në rast të zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KZAZ-ja ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve.".

Neni 10

Në nenin 34 shtohet shkronja "h" me këtë përmbajtje:

"h) bashkërendon me Policinë e Shtetit masat për rendin publik në funksion të zgjedhjeve, si dhe administron dokumentacionin zyrtar për ndërhyrjet e policisë në rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit.".

Neni 11

Në nenin 44, shkronja "c" shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 46 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Një zonë qendre votimi ka jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj.".

2. Shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të këtij ligji.".

Neni 13

Në nenin 47 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Përpunimi, ndryshimi, modifikimi, shtesa apo heqja e emrave apo të dhënave të tjera nga lista jashtë RKGJC-së dhe në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligji përbën vepër penale dhe dënohet sipas nenit 248 të Kodit Penal.".

Neni 14

Në nenin 52 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalia e fundit shfuqizohet.

2. Shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

"6. Kryetari i bashkisë të paktën një herë në javë, si dhe sa herë i kërkohet nga KQZ-ja raporton për zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen. Mënyra e komunikimit me KQZ- në dhe masa administrative e gjobës, që zbatohet ndaj kryetarit të bashkisë në rast mosraportimi, dhe

ekzekutimi i gjobës përcaktohen me vendim të KQZ-së.".

Neni 15

Pika 3 e nenit 53 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 61 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalia e dytë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"Të drejtën për të caktuar auditë e kanë komisioneri dhe nënkomisioneri.".

2. Në pikën 3 pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

"Auditët teknicienë ndihmohen nga jo më shumë se 2 ndihmës, të cilët caktohen nga KQZ-ja me propozimin e auditit.".

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"Çdo audit teknicien ka akses në sistemin elektronik, bazën e të dhënave dhe dokumentacionin e RKGjC-së dhe të zyrave të gjendjes civile, për të bërë të mundur leximin dhe krahasimin e përbërësve të gjendjes civile, ndryshimeve të tyre, kohën kur janë kryer këto veprime nga përdoruesit apo administratorët e sistemit, si dhe të çdo lloj raporti të sistemit elektronik, të cilat gjurmojnë të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur për përbërësit zgjedhorë në RKGjC për periudhën që kontrollohet, duke përfshirë edhe metodologjinë si gjenerohet ky raport. Auditi teknicien ka të drejtë të marrë informacion ose të këqyrë të dhënat e regjistrit që përdoren për ndarjen e mandateve për zonat zgjedhore. Aksesi i auditit në RKGjC në çdo rast është jo më i vogël sesa aksesi që ka drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Gjendjes Civile.".

4. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"KQZ-ja ia përcjell gjetjet dhe rekomandimet e auditëve teknicienë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve, duke i kërkuar njëkohësisht shpjegime për to. Raportet e auditëve dhe shpjegimet e DPGJC-së bëhen publike nga KQZ-ja. Detyra e auditëve teknicienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve përmbushet me raportin përfundimtar për listën e zgjedhësve, pas shpalljes së saj.".

Neni 17

Në pikat 1 dhe 7 të nenit 62 numri "200" bëhet "300".

Neni 18

Në nenin 64 shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet. Teksti i deklaratës përcaktohet nga KQZ-ja.".

Neni 19

Pikat 5 dhe 6 të nenit 67 ndryshohen si më poshtë:

"5. Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për partitë pjesëtare të koalicionit, që garojnë me lista shumemërore të veçanta, numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se gjysma e numrit të mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast numri i kandidatëve në listën shumemërore të partisë duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre.

6. Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumemërore duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini.".

Neni 20

Në nenin 71 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

"4. Procedura e verifikimit të nënshkrimeve është publike dhe bëhet në përputhje me modalitetet e përcaktuara me akt normativ nga KQZ-ja.

5. Në përfundim të procesit të verifikimit të nënshkrimeve KQZ-ja miraton aktin përkatës administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim nga subjekti i interesuar në KAS brenda 3 ditëve.".

Neni 21

Pika 2 e nenit 76 ndryshohet si më poshtë:

"Përllogaritja dhe miratimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore kryhet brenda 15 ditëve nga marrja e të dhënave sipas pikës 1 të këtij neni.".

Neni 22

Përmbajtja e nenit 78 ndryshohet si më poshtë:

1. Gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.

2. Marrëdhëniet e subjekteve zgjedhore me operatorët radiotelevizivë për transmetimin e veprimtarive të fushatës, mesazheve apo reklamave zgjedhore të subjektit u nënshtrohen rregullave, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Rregullat, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në këtë ligj kanë qëllim garantimin e barazisë së subjekteve zgjedhore në garë, sigurimin e paanësisë së operatorëve radiotelevizivë në raport me fushatën dhe subjektet e veçanta zgjedhore, si dhe mbrojtjen e subjekteve zgjedhore nga praktikat e deformimit të mesazhit zgjedhor, censurës dhe përdorimit të kundërligjshëm të medies.

4. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.

5. Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositësin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.

6. Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike.

7. Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet dhe mbajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike.

8. Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre nëpërmjet subjekteve zgjedhore bartin detyrimin për transparencë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas rregullave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

9. Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqe kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj.

10. Nuk përbën shkelje dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët lejohet të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate kur vlera e tyre është më e vogël se pesë qind lekë për send ose material. KQZ-ja mban dhe përditëson listën e sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, me vlerat maksimale për secilin prej tyre.

Neni 23

Neni 79 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 79
Afishimi i materialeve propagandistike

1. Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit.

2. Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë

zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.

3. Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të..." (vijon emri i subjektit zgjedhor).

4. Ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Policia Bashkiake dhe/ose Policia e Shtetit garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore në vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.".

Neni 24

Në nenin 84 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"Media audiovizive përgatit lajmet në liri të plotë editoriale. Kur për shkaqe objektive media nuk është në gjendje të ndjekë veprimtari të veçanta zgjedhore, ajo lejohet të shfrytëzojë dhe përzgjedhë pamje filmike nga regjistrimet e plota të servirura nga subjektet zgjedhore, me kushtin që ta shoqërojë lajmin me shënimin "materiali filmik servirur nga subjekti...".

2. Akronimi "KKRT" zëvendësohet sipas lakimit përkatës me "enti rregullator për mediat audiovizive.".

3. Në pikën 10 fjalët "60 ditë" zëvendësohen me fjalët "4 muaj".

Neni 25

Neni 85 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 85
Monitorimi i fushatës zgjedhore në media

1. Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive. Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.

2. Enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë monitoron zbatimin e rregullave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore me karakter normativ të KQZ-së nga operatorët radiotelevizivë dhe nga subjektet zgjedhore.

3. Jo me vonë se 3 muaj para datës së zgjedhjeve KQZ miraton dhe publikon Metodologjinë e Monitorimit të Medias.

4. Enti rregullator i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht të përjavshme, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Raportet e monitorimit të medias publikohen në faqen e internetit të KQZ-së menjëherë sapo depozitohen në KQZ. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para KQZ-së, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.

5. KQZ-ja urdhëron korrigjimin e sjelljes për operatorët radiotelevizivë ose subjektet zgjedhore, ose, sipas rastit, vendos sanksione administrative ndaj tyre, mbështetur në gjetjet e veta, në ato të raporteve të monitorimit, si dhe në informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej saj. Vendimet e KQZ-së ankimohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë Ligj. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të KQZ-së.

6. Radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të KQZ-së, menjëherë në dispozicion të saj.".

Neni 26

Neni 85/1 shfuqizohet.

Neni 27

Pjesa VII, me nenet 86 deri 92, ndryshohet si më poshtë:

"Neni 86
Burimet e financimit të fushatës zgjedhore

Burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë:

a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore;

b) të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit;

c) dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna, sipas nenit 92/1 të këtij ligji;

ç) huat ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre sipas ligjit. Në asnjë rast vlera e një huaje ose kredie nuk duhet të kalojë shumën e fondeve, sipas pikës 2 të nenit 92/1 të këtij ligji.

Neni 87
Fondet për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve

1. Buxheti i KQZ-së përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit.

2. Në buxhetin e vitit kur do të zhvillohen zgjedhje, Kuvendi vë në dispozicion të KQZ-së dhe të institucioneve të tjera përkatëse fondet për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen, si dhe çdo aspekt tjetër të procesit zgjedhor.

3. Në rastin kur viti buxhetor nuk është vit zgjedhor, KQZ-së i vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për funksionimin e këtij institucioni, si dhe për ushtrimin e përgjegjësive të tij sipas ligjit.

4. KQZ-ja administron fondet e caktuara për zhvillimin e zgjedhjeve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

5. Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, Këshilli i Ministrave vë në dispozicion të KQZ-së fondet, jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpërndarjes së Kuvendit apo organit përkatës të pushtetit vendor.

Neni 88
Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje

1. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Ky fond nuk mund të jetë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.

2. KQZ-ja, brenda 10 ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendorë në shkallë vendi.

3. KQZ-ja përllogarit shumën që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj.

4. KQZ-ja zbret nga shuma e përllogaritur, sipas pikës 3, sanksionet financiare që janë bërë titull ekzekutiv, të vëna për partinë përkatëse, sipas këtij ligji.

5. Shuma e mbetur pas përllogaritjeve të pikës 4 është shuma që përfiton partia pjesëmarrëse në zgjedhje nga Buxheti i Shtetit.

6. Fondi i përcaktuar për t'u shpërndarë sipas këtij neni i jepet secilës parti jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumemërore ose kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore të partisë përkatëse. Partia politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe KQZ-ja, para shpërndarjes së fondit, nënshkruajnë aktmarrëveshje, në të cilën përcaktohet se partia politike pranon fondin e dhënë, se do ta përdorë atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, pranon monitorimin e shpenzimit të tyre prej subjektit dhe kandidatëve të tij, si dhe do të respektojë të gjitha ndalimet që përcaktohen në këtë ligj për ta. KQZ-ja përcakton me akt nënligjor modalitetet e tjera të aktmarrëveshjes që nënshkruhet mes palëve.

7. Në rast se shuma e përllogaritur në pikën 5 të këtij neni është më e lartë se totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të raportuara nga partia politike ose është vlerësuar si e tillë nga KQZ-ja sipas

auditimeve të pavarura apo verifikimeve të saj, atëherë partia politike është e detyruar të kthejë diferencën në KQZ.

8. Në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimin e bërë në pikën 7 të këtij neni, atëherë përjashtohet nga e drejta për të përfituar fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobat.

Neni 89

Kompensimi financiar paszgjedhor

Subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat nuk kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve sipas nenit 88 të këtij ligji, kur marrin jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi, KQZ-ja, jo më vonë se 30 ditë nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, iu kompenson fondet me shumën që rezulton nga shumëzimi i votave të vlefshme të marra prej tyre me vlerën e votës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 88 të këtij ligji.

Neni 90

Trajtimi i dhurimeve, huave dhe kredive

1. KQZ-ja përcakton me vendim rregullat dhe modalitetet e nevojshme për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyre ose të shërbimeve të dhëna, sipas vlerës së tregut në momentin e dhënies së tyre.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, dhurimet në vlera monetare, në natyrë apo në formën e shërbimit që u jepen kandidatëve të subjekteve zgjedhore, si dhe huat ose kreditë e marra nga kandidatët për financimin e fushatës konsiderohen si kontribute për partinë politike për të cilën ata kandidojnë. Për kandidatët e propozuar nga koalicionet, partitë politike pjesëmarrëse në koalicion përcaktojnë në marrëveshjen për krijimin e koalicionit se cila parti do të deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit.

3. Subjekti zgjedhor merr masa për koordinimin e informacionit nga kandidatët e tij gjatë fushatës zgjedhore, si dhe vendos rregullat dhe penalitetet për raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga kandidatët te subjekti zgjedhor, me qëllim që asnjë dhurues, huadhënës ose kredidhënës të mos kalojë limitin e parashikuar nga pika 2 e nenit 92/1 të këtij ligji.

4. Subjekti zgjedhor mban përgjegjësi sipas këtij ligji për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve lidhur me financimin nga ana e kandidatëve të vet, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur dot të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia administrative dhe penalitetet për shkeljen i ngarkohen kandidatit.

Neni 91

Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë

përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike.

Neni 92

Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë

1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

3. Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar te kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

4. Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit "Ndaluar nga KQZ-ja" në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë. Shënimi "Ndaluar nga KQZ-ja" vendoset jo më vonë se dy ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga publiku, nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

5. Veprimtaritë e ndaluara nga KQZ-ja nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me këtë pikë ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji transmetuesin radioteleviziv.

6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.

7. Rregullat për shqyrtimin, kryesisht ose me kërkesë, të rasteve që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 4 të këtij neni, miratohen nga KQZ-ja me akt normativ.

Neni 92/1

Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

1. Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre mund të marrin fonde për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij ligji, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e

tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende ose shërbime. Vlera e shumës sipas fjalisë së parë të kësaj pike, indeksohet nga KQZ-ja çdo pesë vjet sipas normës së inflacionit.

3. Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë. Ky ndalim zbatohet edhe në rastin e nënkontraktimeve apo të kontratave të partneritetit publik privat;

b) ushtron veprimtari në fushën e medias;

c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;

ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.

4. Personat fizikë ose personat juridikë, që i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandidatëve të tij në zgjedhje, nuk mund të përfitojnë për periudhën deri 3 vjet pas datës së zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh, përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik.

5. Subjekti zgjedhor është i detyruar të bëjë publike dhe të sigurojë akses të plotë e të pandërprerë të të tretëve në bazën e të dhënave, ku subjekti zgjedhor regjistron dhurimet, huat ose kreditë e përfituara nga ai dhe kandidatët e tij, për të gjitha vlerat e barabarta dhe më të larta se 50 mijë lekë.

Neni 92/2

Regjistrimi i fondeve jopublike

1. Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 92/1 të këtij ligji dhe mban përgjegjësi personale për deklarim të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi.

2. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në llogari të posaçme të hapura në banka nga subjekti zgjedhor. Llogaritë deklarohen në momentin e regjistrimit sipas nenit 64 të këtij ligji. Në formularin e deklarimit përfshihet edhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë. Subjekti zgjedhor nuk mund të përdorë asnjë llogari tjetër bankare, përveç atyre të deklaruara, për pranimin e dhurimeve për fushatën zgjedhore, qoftë edhe për shuma më të vogla se 50 mijë lekë.

3. Kandidatët e subjekteve zgjedhore, nëse planifikojnë të pranojnë dhurime për fushatën e tyre me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë, janë të detyruar të hapin llogari bankare të posaçme për të pranuar dhurimin e fondeve jopublike. Llogaritë deklarohen në momentin e regjistrimit sipas nenit 67 të këtij ligji. Në formularin e deklarimit përfshihet edhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë. Kandidati i subjektit zgjedhor nuk mund të përdorë asnjë llogari tjetër bankare, përveç atyre të deklaruara, për pranimin e dhurimeve për fushatën zgjedhore, qoftë edhe për shuma më të vogla se 50 mijë lekë.

4. Shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji. Çdo shpenzim i fushatës zgjedhore dokumentohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi. Në zbatim të këtij ligji "shpenzim fushate" është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatës zgjedhore, pavarësisht datës se kur është bërë.

5. Detyrimet e parashikuara në këtë nen vlejnë edhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, të regjistruar sipas neneve 69 dhe 70 të këtij ligji. Shpenzimi total që mund të kryejë kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk duhet të kalojë 50 për qind të shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 88 të këtij ligji.

Neni 92/3
Deklarimi dhe publikimi

1. Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.

2. Raportet financiare hartohen sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja. Raporti, si rregull, duhet të përmbajë informacion, për:

a) çdo dhurim, hua ose kredi që i është dhënë subjektit zgjedhor (duke përfshirë edhe degët dhe kandidatët e tij) gjatë fushatës zgjedhore dhe gjashtë muaj para fushatës dhe burimin e tij, përfshirë edhe dhurimet apo shërbimet në natyrë;

b) të ardhurat për qëllime të fushatës zgjedhore nga të gjitha burimet e tjera të lejuara;

c) të gjithë zërat e shpenzimeve për qëllime të fushatës zgjedhore siç përcaktohen në vendimin e KQZ-së dhe në pikën 4 të nenit 92/2 të këtij ligji;

ç) bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.

3. Çdo parti politike që merr pjesë në zgjedhje mban dhe ruan në arkiv për një periudhë prej 7 vjetësh dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm të statusit të saj financiar dhe të degëve të saj për periudhën që mbulon ky raport, duke përfshirë:

a) librat e llogarive/kontabilitetit, mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku pasqyrohen të gjitha të ardhurat sipas burimit dhe shumës, identifikohet si është bërë pagesa, si dhe pagesat e bëra personave të tretë, qëllimet e pagesave dhe se si është kryer çdo pagesë;

b) dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve të bëra;

c) situatën dhe lëvizjet në llogarinë e saj bankare;

ç) dokumentacionin e plotë të pronave të paluajtshme që zotëron partia politike, si dhe çdo kontratë të lidhur për marrje me qira, dhënie me qira, porositje apo shitje të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme;

d) regjistrin e dhuruesve, huadhënësve dhe kredidhënësve, sipas modelit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 92/2.

Neni 92/4
Monitorimi i fushatës zgjedhore

1. Jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera sipas këtij kreu.

2. KQZ-ja përcakton me një udhëzim të posaçëm kriteret për përzgjedhjen e monitoruesve, si dhe për objektin e monitorimit. Monitorimi kufizohet me vëzhgimin e respektimit të verifikueshëm lehtësisht të detyrimeve të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore, duke përfshirë respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve të formave të caktuara të fushatës dhe shpërdorimit të burimeve shtetërore.

3. Monitorimi nuk duhet t'i ekspozojë monitoruesit ndaj rreziqeve të panevojshme.

4. Monitorimi nuk kërkon që monitoruesit të llogarisin shpenzimet totale për fushatë zgjedhore nga subjekti zgjedhor ose variablat e ndryshme financiare, që kërkojnë mbledhje të metadatave të zgjeruara.

5. Në rastet kur monitoruesit vërejnë shkelje gjatë procesit të monitorimit, ata informojnë KQZ-në, përmes mënyrës së përcaktuar nga KQZ-ja, në të njëjtën ditë që bëhet vëzhgimi.

Neni 92/5
Portali për denoncime në lidhje me financimet

1. KQZ-ja krijon dhe mirëmban portalin në internet, me akses të lirë, për të denoncuar prej kujtdo shkeljet e mundshme të këtij ligji nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët në lidhje me financimin e fushatës.

2. Kriteret dhe procedurat e hollësishme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e portalit, procedurat e hetimit administrativ dhe afatet e tij, si dhe konkluzionet qe duhet të arrihen në përfundim të tij përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

Neni 92/6
Auditimi i fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore

1. Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për çdo parti politike të

regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ- ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, të përzgjedhur sipas nenit 92/7 të këtij ligji, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Raporti i auditimit paraqitet në KQZ brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit. Raporti nuk mund të përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën e parashikuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 92/2 të këtij ligji.

2. Subjektet zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokument apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij ligji.

3. Subjektet zgjedhore që auditohen duhet të vënë në dispozicion çdo informacion që disponojnë nga bankat, institucione apo persona të tretë që kanë lidhje me auditimin ose të autorizojnë auditin për tërheqjen e tyre nga të tretët. KQZ-ja vë në dispozicion të auditit në çdo fazë të auditimit informacionet që i paraqiten nga të tretët për objektin e auditimit.

4. KQZ-ja publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse.

5. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë kre nga subjektet zgjedhore apo dhuruesit, në rast se nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve të Pjesës XIII të këtij ligji.

6. KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, raportin e auditimit sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe çdo informacion tjetër për lëndën për të cilin vihet në dijeni. KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t'i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji.

Neni 92/7
Përzgjedhja e auditëve nga KQZ-ja

1. KQZ-ja përzgjedh me konkurrim një listë të ekspertëve kontabël të licencuar në fillim të vitit zgjedhor.

2. Lista duhet të përmbajë të paktën 20 ekspertë, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në 5 vitet e fundit.

3. Procedurat, kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të tyre përcaktohen me udhëzim të KQZ-së. Në çdo rast një audites nuk mund të auditojë të njëjtin subjekt zgjedhor për dy zgjedhje radhazi.

4. Buxheti për zgjedhjet duhet të parashikojë fondin e nevojshëm për auditimin e subjekteve zgjedhore dhe monitoruesit e shpenzimeve të fushatës zgjedhore. KQZ-ja përcakton me vendim kushtet kontraktuale për këtë gjë.

Neni 28

Në nenin 109 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

"6. Në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar. Përjashtimisht nga ky rregull, lejohet prania e vëzhguesve dhe përfaqësuesve të medias së autorizuar, si dhe e personave të ngarkuar me kryerjen e sondazheve për votimin, kur organizata që ata përfaqësojnë është autorizuar për këtë qëllim nga KQZ-ja. Intervistimi i votuesve për llogari të sondazheve bëhet në rrethinat e jashtme të ndërtesës, në vendintervistimi me shenja të qarta dalluese dhe shpjeguese dhe pa penguar në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak kalueshmërinë dhe hyrje-daljen e lirë të zgjedhësve në qendrën e votimit.

7. Prezenca e personave të tjerë, jashtë parashikimeve të këtij neni, në mjediset ku kryhet administrimi zgjedhor apo në rrethinat e tyre është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin. Ndërhyrja e Policisë së Shtetit bëhet sipas

procedurave të miratuara nga KQZ-ja dhe dokumentohet në detaje nga administrata zgjedhore.”.

Neni 29

Në nenin 123, pikat 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“4. Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KAS, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi.

5. Vendimi i KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i KZAZ-së, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KAS së bashku me ankimin kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 30

Në pjesën X, përpara nenit 124, shtohen nenet 123/1, 123/2 dhe 123/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 123/1
E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në

1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor.

3. Kur kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta kanë lidhje me hetime administrative që kryhen në bazë të këtij ligji për veprimtarinë në zgjedhje të subjekteve zgjedhore, atëherë ato bëhen pjesë e hetimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor.

Neni 123/2
Kompetenca për hetimin administrativ

1. Si rregull, hetimi administrativ kryhet nga administrata e KQZ-së, përveç rasteve kur për hetimin e çështjeve të veçanta legjislacioni zgjedhor kërkon emërimin e ekspertëve jashtë administratës.

2. Hetimi administrativ i kryer nga ekspertët e jashtëm merr vlerë juridike vetëm pasi miratohet nga KQZ-ja, sipas rregullave procedurale në fuqi.

Neni 123/3
Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve

1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave, që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt KQZ-në.

2. Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë sipas pikës 1 të këtij neni mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

3. KQZ-ja miraton modelin e denoncimit, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së informacionit nga publiku.”.

Neni 31

Pas nenit 124 shtohet neni 124/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 124/1
Ankimi administrativ i palëve të treta

1. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias, kanë të drejtë të ankohen në KAS kundër vendimeve që refuzojnë regjistrimin e vëzhguesve brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit.".

Neni 32

Fjalia e fundit e pikës 3 të nenit 138 ndryshohet si më poshtë:

"Secili anëtar ka të drejtë të kërkojë dhe KQZ-ja është e detyruar të kryejë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara në kuadër të kësaj procedure.".

Neni 33

Neni 146 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 146
Kolegji Zgjedhor Gjyqësor

1. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga radhët e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016, nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

2. Shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor hidhet jo më vonë se 48 orë nga data e përcaktimit të datës së zgjedhjeve me të afërta, sipas këtij ligji. Shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda 24 orësh nga hedhja e shortit, miraton me vendim zgjedhjen e gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor delegohen në këtë detyrë me mandat 4-vjeçar. Përtëritja bëhet duke zbatuar procedurat dhe afatet e këtij ligji për përzgjedhjen, delegimin, betimin dhe konstituimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

4. Brenda 3 ditësh nga delegimi në detyrë, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor bëjnë betimin në një ceremoni publike, në prani të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Betimi ka këtë përmbajtje: "Betohem solemnisht se do të respektoj, do të mbroj dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Betohem se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person, parti politike apo subjekt zgjedhor".

5. Konstituimi i Kolegjit bëhet menjëherë pas betimit dhe thirret në detyrë nga Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Në rast se krijohen vakanca në përbërjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, vakanca plotësohet sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj vetëm nga gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016, deri në datën e krijimit të vakancës.

7. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vë në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor mjedise të mjaftueshme pune, pajisje dhe personel, në mënyrë që të sigurojë kryerjen në kohë dhe në mënyrë profesionale të detyrave të veta. Vendimet e Kolegjit botohen në faqen e internetit të Gjykatës Administrative të Apelit.

8. Me kërkesë të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Kolegji rithirret në detyrë sa herë që pranë kësaj gjykate depozitohen ankime ndaj vendimeve të KQZ-së, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 145 të këtij ligji.".

Neni 34

Neni 149 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 149
Mbrojtja e posaçme për gjyqtarët e Kolegjit

1. Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund:

a) t'i nënshtrohet hetimit apo procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar Kolegji;

b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe disiplinore, organizimi gjyqësor apo ngritje në detyrë;

c) të vlerësohet "i pamjaftueshëm" për aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe etikën/ angazhimin ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit.

2. Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi merr edhe mendimin e kryetarit të gjykatës, ku gjyqtari ushtron funksionin, vendos lehtësimin e ngarkesës së punës së tij.

3. Pas përfundimit të delegimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, ushtrimi i detyrës në këtë Kolegj konsiderohet vlerë e shtuar në përvojë për qëllime të ngritjes në detyrë.".

Neni 35

Në nenin 163 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 6 shfuqizohet.

2. Pika 7 riformulohet me këtë përmbajtje:

"7. Shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi nxirret për çdo zonë zgjedhore më vete. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.".

Neni 36

Përmbajtja e nenit 164 ndryshohet si më poshtë:

1. Mandati i deputetit, i fituar sipas neneve 162 dhe 163 të këtij ligji, ndërpritet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës. Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive për heqje dorë nga mandati. Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës.

2. Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë i gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk zbatohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

3. KQZ-ja merr vendim për plotësimin e vakancës në Kuvend. Vendimi i njoftohet kandidatit dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në Kuvend brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës, sipas procedurës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni. E njëjta procedurë vazhdon deri në shterimin e listës së kandidatëve të së njëjtës parti politike.

4. KQZ-ja merr vendim për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë. Vendimi i njoftohet kandidatit. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në këshill brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës, sipas procedurës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

5. Në rastin kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë.

Neni 37

Pas nenit 167 shtohen nenet 167/1 dhe 167/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 167/1
Raportimi për hetimin penal

1. KQZ-ja u kërkon informacion të rregullt organeve të policisë dhe të prokurorisë për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni kërkohet me të dhënat për çështjet penale, personat nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni i vihet në dispozicion KQZ-së jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës për informacion.

3. KQZ-ja është e detyruar që të mbajë, përditësojë dhe publikojë statistikë të rregullt për hetimet penale, me të gjithë informacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe të informojë Kuvendin gjatë raportimeve periodike

ose vjetore, si zë më vete, për gjendjen e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.

Neni 167/2
Këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor

1. Këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor bëhet për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave. Gjatë këqyrjes personeli i KQZ-së, i ngarkuar me këqyrjen, ndjek të njëjtën procedurë që ndiqet nga grupet e numërimit, kur bëjnë vlerësimin dhe numërimin e votave.

2. Këqyrja lejohet të bëhet vetëm pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar. Ky rregull nuk vlen për këqyrjen që bëhet në kuadër të procesit ankimor, si mjet për sigurimin e provës.

3. Këqyrja bëhet nga KQZ-ja, me përzgjedhje rastësore, ose me kërkesë të palëve të interesuara, me përcaktim. Këqyrja kryesisht, si rregull shtrihet në jo më shumë se 10 për qind të qendrave të votimit. Pavarësisht së kush ka marrë nismën për këqyrjen, procesi realizohet nga personeli i KQZ-së në seancë publike, në të cilën ftohen të marrin pjesë kërkuesi dhe përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ. Procesi regjistrohet në video dhe videoregjistrimi ruhet në arkivin e KQZ-së.

4. Në zbatim të këtij neni, KQZ-ja verifikon mbi bazën e të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik nëse rezultojnë votues të shumëfishtë dhe përgatit materialin kallëzues për prokurorinë.

5. Kur këqyrja bëhet me kërkesë të palëve të interesuara, ato mbulojnë shpenzimet administrative të procesit. Nuk lejohet kryerja e këqyrjes së fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë kryesisht ose me kërkesë të palëve të tjera të interesuara. Në rast se një palë e interesuar kërkon këqyrjen e fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë, kërkesa refuzohet duke i ofruar palës së interesuar njëkohësisht videoregjistrimin për këqyrjen e mëparshme.

6. Rregullatori përcakton me akt normativ tarifat e shërbimit administrativ të këqyrjes dhe çmimin e videoregjistrimit.

7. Procedura që zbatohet gjatë këqyrjes është e ngjashme me procedurën që ndjek administrata zgjedhore përgjatë veprimtarisë në zgjedhje.

8. Në rast se nga këqyrja e fletëve të votimit ose e materialit zgjedhor konstatohen parregullsi ose pasaktësi, që bëjnë me faj zyrtarët zgjedhorë përkatës, KQZ-ja është e detyruar të nisë procedimin disiplinor dhe të bëjë kallëzimin penal për zyrtarët përgjegjës.”.

Neni 38

Neni 172 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 172
Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji

1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.

2. Masa e gjobës përcaktohet në varësi nga rrethanat e mëposhtme:

a) rreziku që përbën shkelja për zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve në të ardhmen;

b) fakti nëse autori i shkeljes është anëtar ose i punësuar nga subjekti zgjedhor;

c) kohëzgjatja dhe rrethi i veprimeve që kanë çuar në kryerjen e shkeljes;

ç) fakti nëse ka pasur përpjekje për fshehjen e shkeljes nga ana e subjektit zgjedhor dhe në ç’shkallë kanë qenë ato;

d) veprimet e subjektit zgjedhor pas zbulimit të shkeljes;

dh) fakti nëse në kryerjen e shkeljes kanë marrë pjesë persona zyrtarë ose janë shfrytëzuar burime publike;

e) fakti nëse shkelja është përsëritur;

ë) fakti nëse është kryer në bashkëpunim;

f) rreziku potencial ndaj zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente.

3. Gjobat, sipas pikës 1 të këtij neni, vihen nga KQZ-ja.

4. Shkeljet, sipas pikës 1 të këtij neni, kur kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbëjnë

kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet.".

Neni 39

Përmbajtja e nenit 173 ndryshohet si më poshtë:

1. Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga personi përgjegjës i financës së një partie politike dënohet me një gjobë nga 100 000 deri 200 000 lekë.

2. Pengimi ose mosbashkëpunimi i subjektit zgjedhor me audituesin e KQZ-së dënohet me një gjobë nga 2 000 000 deri 3 000 000 lekë, si dhe me pezullim të financimit publik të partisë politike deri në 5 vjet. E njëjta shkelje e kryer kundrejt monitoruesit të KQZ-së dënohet me gjobë nga 50 000 deri 100 000 lekë.

3. Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh. Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë.

4. Fondet jopublike të përftuara nga një parti politike, identiteti i dhuruesit të të cilave nuk dihet ose nuk përcaktohet qartësisht, transferohen në llogarinë e KQZ-së. Moskalimi çon në konfiskimin e fondeve të marra dhe në një gjobë të barabartë me shumën e fondeve të marra.

5. Pranimi i fondeve private më vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së.

6. Pranimi i fondeve nga donatorë të ndaluar, siç specifikohet në pikën 3 të nenit 92/1, dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra.

7. Shkelja e përcaktimeve të bëra në nenin 92/2 të këtij ligji nga dhuruesit ndëshkohet me gjobë deri në 30 për qind të shumës së dhuruar.

8. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.

9. Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekësh ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë.

10. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij neni. Gjoba e vënë nga KQZ-ja është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet brenda 30 ditësh nga marrja dijeni për të. KQZ-ja përjashtohet nga detyrimi të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbarimor.

Neni 40

Neni 175 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 175
Sanksioni për mosrespektim të barazisë gjinore

Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të këtij ligji passjell refuzimin e listës shumemërore për t'u regjistruar në KQZ ose, sipas rastit, për zgjedhjet vendore në KZAZ.".

Neni 41

Neni 179 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 179
Prokurimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit

1. Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që do të përdoren në zgjedhje do të implementohen me projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më shumë se 20 për qind të zgjedhësve, duke filluar nga zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pavarësisht nga ky rregull, në zgjedhjet e para për Kuvendin, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, identifikimi elektronik do të shtrihet në 100 për qind të votuesve.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë alokon në buxhetin e KQZ-së fondin e nevojshëm për prokurimin, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve dhe implementimin e teknologjisë që do

të përdoret në zgjedhje do të kryhen sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik, me një nga procedurat më afatshkurtra që lejon ky ligj për këtë prokurim.

Neni 42

Neni 180 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 180
Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti

1. Zbatimi i nenit 88 të këtij ligji për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të tij bëhet duke kryer përllogaritjet në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

2. Për secilën parti përfshihet në përllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërën nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse. Në përllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre.

3. Totali i fondit buxhetor që është për t'u shpërndarë pjesëtohet me totalin e votave të përftuara nga përllogaritjet sipas pikës 2 të këtij neni. Rezultati që del formon vlerën në lekë për një votë.

4. Në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, fondi nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje do të jetë 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.".

Neni 43

Neni 181 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 181
Zgjedhja e Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe KAS-it

Procedurat për zgjedhjen e Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe anëtarëve të KAS-it fillojnë jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.".

Neni 44

Neni 182 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 182
Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KQZ-së

1. Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, lirohen nga detyra me zgjedhjen e Komisionerit sipas këtij ligji.

2. Anëtarët e liruar nga detyra përfitojnë nga KQZ-ja pagën e plotë deri në datën kur duhet të mbaronte mandati i tyre. Pas kësaj date, ata trajtohen në përputhje me ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar.

3. Komisioneri, nënkomisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe të KAS-it zgjidhen jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.".

Neni 45

Neni 183 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 183
Formimi kalimtar i organeve drejtuese dhe i administratës zgjedhore

1. Komisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e KAS-it zgjidhen herën e parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në bashkëveprim me partitë parlamentare të dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, që kanë humbur përfaqësimin parlamentar. Zgjedhja e organeve drejtuese të KQZ-së bëhet sipas radhës së përcaktuar në këtë pikë.

2. Partitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni autorizojnë një përfaqësues me cilësinë e të

dërguarit të posaçëm pranë komisionit parlamentar, që ngrihet në zbatim të nenit 17 të këtij Kodi. I dërguari i posaçëm merr pjesë në procedurën e shqyrtimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave nga komisioni parlamentar.

3. Komisioni parlamentar përzgjedh tre kandidatë nga lista e kandidatëve për komisioner, të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij ligji për komisionerin. I dërguari i posaçëm eliminon njërën nga kandidaturat e përzgjedhura. Dy kandidaturat e tjera i paraqiten për votim Kuvendit, i cili vendos me shumicë votash.

4. I dërguari i posaçëm ka të drejtë të përzgjedhë tre kandidatë nga lista e kandidatëve për nënkomisioner, të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij ligji për komisionerin. Komisioni me votim eliminon njërën nga kandidaturat e përzgjedhura. Dy kandidaturat e tjera i paraqiten për votim Kuvendit, i cili vendos me shumicë votash.

5. Anëtarët e Rregullatorit zgjidhen me listë të përbashkët, me pesë emra, midis kandidaturave që plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij ligji për Rregullatorin. I dërguari i posaçëm ka të drejtë të përfshijë dy emra kandidatësh në këtë listë. Projektvendimi për përbërjen e Rregullatorit-it i kalon për votim Kuvendit dhe miratohet me shumicë votash.

6. Anëtarët e KAS-it zgjidhen me listë të përbashkët, me pesë emra, midis kandidaturave që plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij ligji për KAS-in. I dërguari i posaçëm ka të drejtë të përfshijë dy emra kandidatësh në këtë listë. Projektvendimi për përbërjen e KAS-it i kalon për votim Kuvendit dhe miratohet me shumicë votash.

7. Tre anëtarë të KAS-it, në përfundim të afatit prej katër vjetësh nga data e zgjedhjes së tyre, sipas këtij neni, mbarojnë detyrën. Anëtarët që mbarojnë detyrën caktohen me short të hedhur nga KQZ-ja në seancë publike, jo më vonë se 30 ditë përpara mbarimit të afatit 4-vjeçar. Zëvendësimi i tyre bëhet sipas procedurave të këtij ligji, me anëtarë të rinj, të cilët zgjidhen për një mandat 9-vjeçar. Anëtarët që lirohen nga detyra gëzojnë të drejtën për të rikandiduar.

8. Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.".

Neni 46

Përmbajtja e nenit 184 ndryshohet si më poshtë:

"Ngarkohet KQZ-ja të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij.".

Neni 47

Neni 180/1, aneksi I, shtojca II dhe shtojca III shfuqizohen.

Neni 48

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11573, datë 31.7.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11573, datë 31.7.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 101/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 143
Datë: 2020/08/04 12:55:04
82f816ff-4638-446d-b3f6-c1125ecec32f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë